



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës**

*Kukes me 05.12.2018*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: **CURRI”sh.p.k.** Adresa: Njesia Bashkiake nr 10 Rruga Kajo Krafil, Pallati Bimbashi 8/2 Kati II, Ap.2B.Tiranë.

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-80757-07-26-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca , maternitetit , administrata)**“ me fondin limit 163.832.500 (njqind e gjashtedhjetë e tre milion e teteqind e tridhjetë e dy mijë e peseqind) leke pa TVSH me afat 24 muaj nga nenshkrimi i kontrates]

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Date 30.07.2018] [Nr.30].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët v

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.BOE: „Lala sh.p.k. & Shansi Invest sh.p.k. & Biba-X”

Nipt : J76418903B      nipt : J61924002T      nipt:K32618815N

Vlera 150.726.332(*njqinde e pesedhjetë milion e shtateqinde e njezet e gjashtë mijë e treqinde e tridhjet e dy*).

2.BOE: BE-IS Shpk

Nipt : K71412003A

Aurora konstruksion shpk

Nipt : K 02017003 I

Vlera 154.573.735,11(*Njqinde e pesedhjetë e kater milion e peseqinde e shtatedhjetë e tre mijë e shtateqinde e tridhjetë e pese presje njembedhjetë*)leke pa TVSH.

3. CURRI Shpk

J67902718S

Vlera 162.719.557,08(*njqinde e gjashtë dhjetë e dy milion e shtateqinde e nentembedhjetë mijë e peseqinde e pesedhjetë e shtate presje zero tete*) leke pa TVSH.

4. ELDA-VL Shpk

K67106202W

## Vlera *pa oferte*

5. ROYAL BEART Shpk

K02701025C

Vlera 300.000(Treqinde mije) leke pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- |                          |                      |
|--------------------------|----------------------|
| 1. BOE: Lala shpk        | me nipt : J76418903B |
| Shansi Invest            | me nipt : J61924002T |
| Biba-X”                  | me nipt : K32618815N |
| 2. BOE: BE-IS Shpk       | me nipt : K71412003A |
| Aurora konstruksion shpk | me nipt : K02017003I |
| 3. ELDA-VL Shpk          | me nipt : K67106202W |
| 4. ROYAL BEART Shpk      | me nipt : K02701025C |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme: BOE “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk S’kualifikohet se nuk paraqiti : 1. Kapaciteti teknik nuk ka paraqitur nje Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure ). b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure). Kontratat e paraqitura nga subjektet e bashkimit te operatoreve ekonomike nuk jane te njejta me objektin e prokurimit , pra nuk jane kontrata te ngjashme(kontrata pune rikonstruksion godine ) si dhe kryesuesi i bashkimit, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3.1 ne Dokumentat standarte te tenderit , duhet të plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Pra për rastin konkret kryesuesi i këtij bashkimi nuk ka paraqitur kontratë pune të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Por edhe i gjithë bashkimi i operatoreve ekonomike në total nuk ka paraqitur kontrata pune të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar.

2. Në akt marrëveshje përcaktohet qartë ndarja në %-je të punimeve që do të realizojë secila nga shoqëritë por në tërësinë e kategorive të punimeve që përmban preventivi ka raste kur %-ja e punimeve ne total eshte me e larte se 100% , dhe që nënkupton se nuk ka një ndarje të qartë të shprehur në % në raport me %-en e deklaruar dhe konkretisht : “LALA”shpk “Biba X”shpk “Shansi invest”shpk - - .2.426 Prishje mur tulle pa pastrim 26% 31% 44% - 2.426/6 Prishje mure beton/arme 33% 33% 33% - Analiz Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme 38% 50%

13%, =101% - 2.291 Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend 50% 33% 18%, =101% - 2.114/1 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m<sup>3</sup> C - 16/20. 62% 31% 8%, = 101% - Heqje zgara dritare ekzistuese 63% 25% 13%, =101% - 2166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm 38% 44% 19%, =101% - 2.300 Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah 50% 32% 19%, =101% - 2.491/c F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN . 16 48% 40% 13%, =101% - 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) 44% 19% 38%, =101% - 2.494 F.V Saracineska bronzi Ø ½ " = 15 mm 63% 25% 13%, =101% - 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm 56% 17% 28% =101% - 2.493/1 F.V.Tubo çeliku pa tegel ASTM, A106GR DN 4" 35% 35% 31% , =101% - Sistemi i shkarkimit te ujrave te zeza 42% 33% 26% =101% 3. Kontrata me Inxhinierin e ndertimit z.Agur Shehaj ka mosperputhje te dates se lidhjes se kontrates me daten e hyrjen ne fuqi te saj , pasi ajo eshte lidhur me date 12.03.2015 por ne nein 4 te saj shprehet se kjo kontrate lidhet nga data 02.01.2015 dhe ne Kodin e Punes nuk njihen kontratat me prapaveprim , pra na shtyn te besojme ne fiktivitetin e kesaj kontate. 4. Kontrata me Inxhinierin e ndertimit z.Genc Ajazi ka mosperputhje te dates se lidhjes se kontrates me daten e hyrjen ne fuqi te saj , pasi ajo eshte lidhur me date 13.02.2017 por ne nein 4 te saj shprehet se kjo kontrate lidhet nga data 28.01.2017 dhe ne Kodin e Punes nuk njihen kontratat me prapaveprim , pra na shtyn te besojme ne fiktivitetin e kesaj kontate. 5. Inxhinieria z.Dallendyshe Cengu nuk eshte ne Licencen nr. NZ .4319/5 te subjektit Biba –X shpk.

BOE: BE-IS Shpk & Aurora konstruksion shpk S'kualifikohet se nuk paraqiti:

Vërtetimi i paraqitur nga Bashkia Durrës për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017, nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik "BE-IS" sh.p.k ka ushtruar aktivitet në Bashkinë e Durrësit deri në datën 05.12.2017, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur është lëshuar përpara datës së mbylljes së aktivitetit dhe vërteton shlyerjen e detyrimeve deri në datën 24.08.2017.

Nga verifikimi i dokumentave ka rezultuar se shoqëria "AURORA KONSTRUKSION" sh.p.k ka ushtruar aktivitet në qytetet Berat, Korçë dhe Elbasan që prej datës **02.06.2018**. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë vertetim se ka shlyer taksat dhe tarifatat vendore për këto bashki megjithëse procedura është zhvilluar në datë 10.09.2018. Deklarimi se për këto nipte sekondare autoritetet përkatëse nuk kanë nxjerrë akoma detyrimin nuk gëzon asnjë bazë ligjore kur nga data e zhvillimit të tenderit dhe datës së fillimit të ushtrimit të aktivitetit në këto njësi ka pasur një afat afërsisht 3 mujor.

Pas një verifikimi të kryer në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit <http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>, lidhur me organizmat e akredituara nga DPA, rezulton se: Kompania **AQScert**, Nuk është e akredituar për standardin BS PAS 99:2012.(AURORA) Nuk është i akredituar për standartin ISO EN 3834-2:2005 (BE-IS).

Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit rezulton se kompania **RIG CERT** e cila ka certifikuar shoqërinë "BE-IS" sh.p.k dhe shoqërinë "Aurora Konstruksion" Sh.p.k për nuk figuron në listën e organizmave të akredituara nga DPA.

Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit rezulton se kompania **KING CERT** e cila ka certifikuar shoqërinë "Aurora Konstruksion" Sh.p.k për nuk figuron në listën e organizmave të akredituara nga DPA. Gjithashtu nga verifikimet në kryera në faqen zyrtare on-line të kompanisë KING CERT, Nuk rezulton të jetë e akredituar për sistemin e

menaxhimit ISO EN 3834-2:2005.

BOE "BE-IS" SH.P.K & "AURORA KONSTRUKSION" SH.P.K nga 5 (pese) Specialist Ndertimi të pajisur me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik te kerkuar ne DST-ne e prokurimit, BOE kanë paraqitur 4 (katër) Specialist Ndertimi si dhe nga 4(kater) Elektro/mekanik të pajisur me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik BOE te kerkuar ne DST-ne e tenderit, BOE kanë paraqitur vetem 2 (dy) Elektro/mekanik.

"Aurora Konstruksion" Sh.p.k nuk ka paraqitur një kontratë të vetme në shumën 81,916,250 lekë pa TVSH. Gjithashtu BOE duhet të plotësoj kushtin për më shumë se një kontratë, në raport me përqindjen e pjesmarrjes në vlerën totale 327,665,000 lekë pa TVSH. Operatori ekonomik "Aurora Konstruksion" Sh.p.k në kushtet kur ka marrë përsipër të kryejë 55% të punimeve duhet të paraqiste më shumë se një kontratë në vlerën totale 180,215,750 lekë pa TVSH. Totali i kontratave të paraqitura nga ky operator ekonomik janë në shumën 168,001,489 lekë pa TVSH.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka konstatuar se BOE "BE-IS" Sh.p. & "Aurora Konstruksion" Sh.p.k ka ndarë përqindjet e punimeve që do te kryhen në vlerë totale 45 % të tyre shoqëria "BE-IS" Sh.p.k dhe 55% të punimeve totale "Aurora Konstruksion" Sh.p.k, por duke llogaritur vlerat e zërave të punimeve qe ka marrë përsipër sejcili operator ka një mospërputhje me atë cka është ndarë në akt-marrëveshje nga ky BOE. Nga llogaritja e zërave të punimeve të marra përsipër KSHA konstaton se shoqëria "BE-IS" Sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë **45.38 %** të vlerës totale të punimeve ndërsa shoqëria "Aurora Konstruksion" Sh.p.k **54.62 % të** të vlerës totale të punimeve.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka konstatuar se shoqëria "Aurora Konstruksion" Sh.p.k megjithëse është kompania lider e këtij BOE nuk ka paraqitur asnje mjet Autobot Uji me peshe mbajtese jo me pak se se 10 tone dhe Mjet per pastrimin e rrugeve si dhe nga 4 kamiona të kërkuar ka paraqitur vetëm 1 copë.

OE: ELDA-VL Shpk S'kualifikohet se nuk paraqiti Oferten ekonomike.

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet 2015-2016-2017 ku vlera mesatare e tre viteve duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës limit së fondit limit që prokurohet.

Vertetim per nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve 2015, 2016 dhe 2017. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të ketyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara me shkresë te vecante nga ky autoritet si dhe te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen nga janari 2017 deri ne korrik 2018. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithe vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure ).

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP- 1D (Punime germimi ne toke)
- NP-3G (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)
- NP-12 E Punime te Inxhinierise se Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS-2 D (Impjante hidrosanitare etj)
- NS-4 D (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).
- NS-12 D( Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit)
- NS-14A (Impjante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV)
- NS-18 B (Punime topogjeodezike)

Numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Janar 2017- Qershor 2018 të jetë mesatarisht 70 punonjës në muaj (përfshire dhe stafin drejtues teknik dhe jo drejtues teknik-inxhinier si dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme), të vërtetuar me;

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Janar 2017- Qershor 2018.

b. List- pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohe nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2017- Qershor 2018.

Stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij (sipas tabelës së mëposhtme) me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV per secilin inxhinier, si dhe te jenë të pasyruar në listëpagesat e operatorit ekonomik prej Janar 2018 e ne vazhdim, per:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier hidroteknik

1 (një) Inxhinier gjeodet

1 (një) Inxhinier elektrik

1 (një) Inxhinier mjedisi

OE:ROYAL BEART Shpk S'kualifikohet se nuk paraqiti:

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet 2015-2016-2017 ku vlera mesatare e tre viteve duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës limit së fondit limit që prokurohet.

Vërtetim per nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve 2015, 2016 dhe 2017. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të ketyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara me shkresë te vecante nga ky autoritet si dhe te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe

tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen nga janari 2017 deri ne korrik 2018. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithe vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure ).

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

#### PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP- 1D (Punime germimi ne toke)
- NP-3G (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)
- NP-12 E Punime te Inxhinierise se Mjedisit

#### PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS-2 D (Impjante hidrosanitare etj)
- NS-4 D (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).
- NS-12 D( Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit)
- NS-14A (Impjante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV)
- NS-18 B (Punime topogjeodezike)

Numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Janar 2017- Qershor 2018 të jetë mesatarisht 70 punonjës në muaj (perfshire dhe stafin drejtues teknik dhe jo drejtues teknik-inxhinier si dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme), të vërtetuar me;

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Janar 2017- Qershor 2018.

b. List- pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2017- Qershor 2018.

Stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij (sipas tabelës se mëposhtme) me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV per secilin inxhinier, si dhe te jenë të pasyruar në listëpagesat e operatorit ekonomik prej Janar 2018 e ne vazhdim, per:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier hidroteknik

1 (një) Inxhinier gjeodet

1 (një) Inxhinier elektrik  
1 (një) Inxhinier mjedis

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [subjektin : “CURRI”sh.p.k. Adresa: Njesia Bashkiake nr 10 Rruga Kajo Krafili, Pallati Bimbashi 8/2 Kati II, Ap.2B.Tiranë] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [162.719.557,08(njeqinde e gjashtedhete e dy milion e shtateqinde e nentembedhete mije e peseqinde e pesedhjte e shtate presje zero tete leke pa Tvsh]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Spitali Rajonal Kukës me adrese lagjja 7 Zabel] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.10.2018

Ankesa: ka pasur nr.1011 prot date 08.10.2018 , kane marre pergjigje me shkresen nr.1046 prot date 16.10.2018 dhe ankesa me nr.1015 prot date 09.10.2018 ka marre pergjigje me shkresen nr.1045 prot date 16.10.2018 te Autoritetit Kontraktor , ankesa nr.1636prot date 24.10.2018 ne Komisionin e Prokurimit Publik dhe ka marr pergjigje me Vendimin nr.814/1prot date 27.11.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik.

**Titullari i autoritetit kontraktor**

**Dr.Ismet NIKA**